




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 10.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të dt. **21.09.2021 dhe 22.09.2021** të parashtruar nga: *Operatori Ekonomik N.T.SH. "ATOM MED"* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizime mjekesore për Laborator**" me nr. identifikues 651-21-4661-1-1-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 021 038 211 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e paplotë** – kërkesa për ri-shqyrtim e *Operatori Ekonomik N.T.SH. "ATOM MED"* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizime mjekesore për Laborator**" me nr. identifikues 651-21-4661-1-1-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 021 038 211 e datës **01.10.2021** kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës **28.09.2021** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 28.09.2021.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.SH. "ATOM MED" ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizime mjekesore për Laborator**" me nr. identifikues 651-21-4661-1-1-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 021 038 211 . Autoriteti Kontraktues me datë **05.10.2021** ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga *Operatori Ekonomik N.T.SH. "ATOM MED"* Autoriteti Kontraktues (AK)- *Kuvendi Komunal Gjilan* ka konstatuar se kërkesa e parashtruar nuk përmban elementet thelbësore sipas Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim

pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave Nenit 5 Përmbajtja Themelore e një kërkesë për rishqyrtim të dorëzuar tek Autoriteti Kontraktues. Pasi që OE përmesë platëformës e – prokurimi tek butoni Kërkesat për Rishqyrtim ka ngarkuar Njoftimin për Kontratë.

Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Gjilan – bazuar në **Nenin 6.2. të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese**, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, *me dt.05.10.2021 ka njoftuar OE përmes platformës elektronike e-prokurimi se për vazhduar më tutje me këtë procedurë kërkesën tuaj mundë ta plotësoni dhe dorëzoni pran AK brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës.*

Pasi që sipas afateve ligjore parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim refuzohet si e paplotë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi



Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.